



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.544/8 prot

Datë 01.04.2025

V E N D I M

Nr. 428/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e operatorit ekonomik “INET” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-17555-08-30-2024, me objekt “*Digjitalizimi i dhënies së shërbimit të parkimit me abonime, shërbimit të rezidentit dhe shërbimit taxi me anë të platformës Tirana Parking*” me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2024 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “INET” SHPK me NIPT K81607039F me adresë Njësia Administrative nr.5, Rruga “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, Kati 3, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Tirana Parking, me adresë: Rruga “Ali Begeja”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02-09-2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-17555-08-30-2024, me objekt “*Digjitalizimi i dhënies së shërbimit të parkimit me abonime, shërbimit të rezidentit dhe shërbimit taxi me anë të platformës Tirana Parking*” me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2024 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.

II.2. Në datën 23-09-2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 17.01.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar si më poshtë:

1. “Advanced Business Solutions – ABS” SHPK	7,530,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
2. “3i Solutions” SHPK	8,302,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
3. “1 UP LABS” SHPK& “Vodafone Albania” SHA	9,260,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
4. “Instant.AI” SHPK	8 5 000 000 lekë pa tvsh	skualifikuar
5. “Inet” SHPK	9 500 000 lekë pa tvsh	skualifikuar
6. “Icom” SHPK	pa ofertë ekonomike	

Operatori Ekonomik “Inet” shpk rezulton i skualifikuar me arsyetimin si më poshtë vijon:

Në dokumentacionin e paraqitur nga O.E për përmbushjen e pikës 2.3.1. për Kapacitetin Teknik: “Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të shërbimeve të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme...” rezulton se tek vërtetimi i realizimit të kontratës së ngjashme mungon data e përfundimit/realizimit të kontratës”.

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 21.02.2025 është publikuar njoftimi i anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 25.02.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 544/2025 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5082 e operatorit ekonomik “INET” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. Nr. REF-17555-08-30-2024, me objekt “*Digjitalizimi i dhënies së shërbimit të parkimit me abonime, shërbimit të rezidentit dhe shërbimit taxi me anë të platformës Tirana Parking*” me fond limit: 10000000.0 (dhjetë milion) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2024 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Inet” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 544/1 prot., datë 26.02.2025 referuar arsyes së skualifikimit të ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “INET” SHPK.

II.7. Me shkresën me nr. 544/2 prot., datë 10.03.2025 me lëndë “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “INET” SHPK, drejtuar autoritetit kontraktor Tirana Parking, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar të dorëzojë pranë KPP-së informacion të hollësishëm mbi procedurën e prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimin të ofertave, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.8. Me shkresën me nr. 47 prot., datë 13.03.2025 me lëndë “Shtyrje afati”, protokolluar me tonën me nr. 544/3 prot., datë 13.03.2025 drejtuar operatorit ekonomik “Inet” SHPK dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik autoriteti kontraktor ka informuar se: “[...]ka nevojë të bëjë një verifikim më të detajuar që shërben për shqyrtimin e ankesës së paraqitur dhe i është drejtuar organit kompetent. Ndodhur në këto kushte, për të dalë në një vendim përfundimtar, AK i nevojitet shtyrja e afatit të shqyrtimit, pasi jemi në pritje të informacionit të kërkuar”.

II.9. Me shkresën me nr. 47/10 prot., datë 25.03.2025 dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, protokolluar me tonën me nr. 544/4 prot., datë 25.03.2025, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendim nr. 10, datë 25.03.2025 i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “INET” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës. Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

“[...] Nga shqyrtimi i pretendimeve të operatorit ekonomik, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (më poshtë referuar si KSHA), vëren se:

Sipas nenit 114 pika 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar citohet se: “Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar.

Referuar rrethanave të mësipërme autoriteti kontraktor ju drejtua organit kompetent për të bërë verifikimet e duhura. Me datë 18.03.2025 është kthyer përgjigje ku na është vënë në dispozicion formular raportimi për zbatimin e kontratës, ku në të cilin është pasqyruar qartë fillimi dhe përfundimi i kontratës.

Sa argumentuam më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA), gjykon që pretendimi i operatorit ekonomik “Inet” SHPK qëndron dhe do të merret parasysh.

Bashkëlidhur gjeni Formular Raportimi për zbatimin e kontratës.

VENDOSI:

1. Pranimin e plotë të ankesës së operatorit ekonomik “INET” SHPK.

II.10. Me shkresën me nr. 47/11 prot., datë 25.03.2025, protokolluar me tonën 544/5 prot., datë 28.03.2025 me lëndë “Kthim përgjigje”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Procesverbal vlerësimi dhe klasifikimi, si dhe vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës nr. 10, datë 25.03.2025, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës, si më sipërcituar.

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ nuk rezulton, të jenë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “INET” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën me nr. 47/10 prot., datë 25.03.2025, dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike protokolluar me tonën me nr. 544/4 prot., datë 25.03.2025, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendim nr. 10, datë 25.03.2025 i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “INET” SHPK, për procedurën e

mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës. Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

“[...] Nga shqyrtimi i pretendimeve të operatorit ekonomik, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (më poshtë referuar si KSHA), vëren se:

Sipas nenit 114 pika 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar citohet se: “Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar.

Referuar rrethanave të mësipërme autoriteti kontraktor ju drejtua organit kompetent për të bërë verifikimet e duhura. Me datë 18.03.2025 është kthyer përgjigje ku na është vënë në dispozicion formular raportimi për zbatimin e kontratës, ku në të cilin është pasqyruar qartë fillimi dhe përfundimi i kontratës.

Sa argumentuam më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA), gjykon që pretendimi i operatorit ekonomik “Inet” SHPK qëndron dhe do të merret parasysh.

Bashkëlidhur gjeni Formular Raportimi për zbatimin e kontratës.

VENDOSI:

1. Pranimin e plotë të ankesës së operatorit ekonomik “INET” SHPK. ”

III.1.2. Neni 30 i LPP, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik argumente në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe për këtë fakt, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “INET” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-17555-08-30-2024, me objekt “Digjitalizimi i dhënies së shërbimit të parkimit me abonime, shërbimit të rezidentit dhe shërbimit taxi me anë të platformës Tirana Parking” me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2024 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.

2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin sipas konstatimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INET” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fioorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

